

C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale është iniciativa e parë e kësaj natyre e zbatuar në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që synon të krijojë një model të ri-përdorimit të qendrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, nga organizatat e shoqërisë civile. C.A.U.S.E. zbatohet nga Partnerët Shqipëri, në partneritet me Project Ahead dhe Comitato Don Peppi Diana, dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Buxheti total: 59,978.86 Euro

Kontributi i BE: 56,979.92 Euro (95%)

Periudha e zbatimit: 3 maj 2019 – 2 maj 2020

Organizata zbatuese: Instituti i Zhvillimit, Migracionit dhe Integritimit (IMZHI)

Garazhi Social i Artizanatit

Garazhi Social i Artizanatit

është një punishte e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Sarandë, ku gra dhe vajza – viktime apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje, prodhojnë punime artizanale duke përdorur gurët e detit (shumëngjyrësh, njëngjyrësh, të sheshtë, shkëmb, qelqi, etj.). Gurët ngjyrosen, shpohen, gdhenden dhe punohen duke krijuar produkte të ndryshme artizanale të gatshme për treg.

Modelet e punimeve ndërlihen me trashëgiminë kulturore dhe folklorin duke i bërë këto produkte unike, të vlefshme dhe konkurruese në tregun artizanal, në mënyrë që të sigurohet gjenerimi i të ardhurave në nivel afatgjatë.

Duke i dhënë një fytyrë të re pronës së konfiskuar, sipërmarrja përçon një mesazh të fuqishëm mbi vlerën që ka ri-përdorimi i këtyre aseteve në mbështetje të përfshirjes sociale dhe zhvillimit e ekonomisë lokale.

Gjatë vitit të parë
të zbatimit

- 8 vajza dhe gra viktime apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje të trajnuara dhe punësuar mbi prodhimin artizanal të gurit;
- Garazhi Social i Artizanatit Sarandë shërben si një **Hub Social** në mbështetje të integritimit ekonomik dhe social të grave dhe vajzave në jetën e qytetit;
- Mbi **1,000** produkte artizanale të prodhuara me gurë deti;
- 2 programe trajnimi** mbi trashëgiminë kulturore dhe të drejtat e njeriut;
- Organizimi i **2** ekspozitave lokale.

